

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

GJYKATA ADMINISTRATIVE në këshillin e përbërë nga gjyqtarët mr. Burim Sejdini - kryetar i këshillit, mr. Aneta Xhigerova dhe Gazmend Fejzuli, me procesmbajtës Ate me Muamedin - këshilltar gjyqësor, duke vendosur sipas padisë së paditësit Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë - Bashkësia e Interesit Ekonomik Shkup, përmes Kryetarit Trajan Angellovski nga Shkupi, e parashtruar përmes të autorizuarit Aleksandar Giçev avokat nga Shkupi, kundër Aktvendimit PK nr. 09-32/13 të datës 23.05.2025 të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni për Vendimarrje për Kundërvajtje, me vlerë të objektit të kontestit 100,000.00 denarë, pas mbajtjes së seancës publike me datë 13.11.2025, në prani të të autorizuarit të paditësit Rozita Xhartovska avokat nga Shkupi, dhe në prani të përfaqësuesve të autorizuar të organit të paditur, më datë 20.11.2025, e solli dhe e shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Padia e paditësit Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë - Bashkësia e Interesit Ekonomik Shkup, përmes Kryetarit Trajan Angellovski nga Shkupi e deklaruar kundër Aktvendimit PK nr. 09-32/13 të datës 23.05.2025 të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni për Vendimarrje për Kundërvajtje, REFUZHET SI E PABAZUAR.

AKTVENDIM

Kërkesa e paditësit që të ngarkohet organi i paditur t'ia kompensojë shpenzimet në procedurë sipas kontestit administrativ të iniciuar, REFUZHET.

Arsyetim

Me aktvendimin e kontestuar PK nr. 09-32/13 të datës 23.05.2025 të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni për Vendimarrje për Kundërvajtje, është konstatuar se tani paditësi ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi 1 pika 10 nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, për çka i është shqiptuar gjobë në shumë prej 100.000,00 denarë, të cilën është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit.

I pakënaqur nga aktvendimi i organit të paditur, paditësi inicion kontest administrativ me propozim që padia të aprovohet, ndërsa aktvendimi i kontestuar të anulohet, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Në padi theksohet se deklaratat e personave Suzana Janevska dhe Sasho Dukovski nuk ishin dhënë me paramendim ose me qëllim të vetëdijshëm për vënien në lajthitje të organit të paditur. Përkundrazi, deklaratat e tyre ishin dhënë në kushte të presionit të lartë psikologjik dhe në gjendje stresi, të shkakuar nga karakteri i papritur dhe për ta i pazakontë i marrjes në pyetje. Gjithashtu, theksohet se organi i paditur ka pasur qasje të plotë në dokumentacionin e përgjithshëm, me qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet relevante dhe postën elektronike, me ç'rast nuk kanë ekzistuar kurrfarë pengesash në procesin e hetimit. Të gabuara janë pretendimet e notuara në Procesverbalin nr. 09-15/2 të datës 07.02.2024 dhe Procesverbalin nr. 09-15/8 të datës 11.02.2025, për shkak se

organi i paditur, gjatë konstatimit të gjendjes faktike, nuk e ka marrë parasysh pasqyrën e plotë të rrethanave nën të cilat ishin dhënë deklaratat, natyrën e informacioneve, shkallën e bashkëpunimit me organin, si dhe mungesën e qëllimit të vetëdijshëm për lajthitje. Në rastin konkret nuk ekziston elementi i kundërvajtjes, sepse qëllimi i vetëm i nenit 61 paragrafi 1 pika 10 është që të parandalohet pengimi i vetëdijshëm ose vënia në lajthitje e organit të paditur, diçka që jo vetëm që nuk ka ndodhur, por është edhe pa mëdyshe e përjashtuar.

Gjykata deri te organi i paditur më datë 12.06.2025 dorëzoi ftesë për përgjigje në padi, e dorëzuar në rregull më datë 03.10.2025, e dukshme nga dëftesa e nënshkruar e dorëzimit në shkresat.

Organi i paditur më datë 19.06.2025 dorëzoi në Gjykatë Përgjigje në padi me arsyetim se mbetet në tërësi pranë pretendimeve të paraqitura në Aktvendimin PK nr. 09-32/13 të datës 23.05.2025, dhe i propozojnë Gjykatës të sjellë aktgjykim me të cilin padia do të refuzohet si e pabazuar dhe do të konfirmojë Aktvendimin e Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës PK nr. 09-32/13 të datës 23.05.2025. Theksoi se Komisioni i ka marrë parasysh të gjitha provat relevante për konstatimin e kundërvajtjes së lëndës, jo vetëm deklaratat e përfaqësuesve të paditësit, por edhe deklaratat e pjesëmarrësve të tjerë të takimit kontestues, deklaratën e Risto Shehtanski, menaxher kryesor për furnizime në KAM, dhënë në procesverbalin e datës 10.02.2025, i cili ka marrë pjesë në takimin kontestues, deklaratën e Vladimir Todoroviq, drejtues i TINEKS MT SHPKNJP, dhënë në procesverbalin e datës 13.02.2025, si dhe komunikimin elektronik të siguruar gjatë procedurës. Të pasakta janë pretendimet e Suzana Janevskës se qysh në procesverbalin e datës 07.02.2025 i ka theksuar të gjitha marketet që kanë marrë pjesë në takimin kontestues. E dukshme nga vetë procesverbali i datës 07.02.2025, i cili është nënshkruar me dorë nga Suzana Janevska, në pyetjen lidhur me atë se me kë është mbajtur takimi me përfaqësuesit e zinxhirëve të shitjes me pakicë dhe partnerët lokalë kyç siç theksohet në komunikatën për opinion të dhënë nga Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë, personi i autorizuar Suzana Janevska ka deklaruar se nuk ka qenë e përfshirë në atë takim. Nga vetë pretendimet në procesverbal rezulton se takimi është mbajtur vetëm nga ana e Sasho Dukovskit, e jo nga Suzana Janevska, gjë që i vë në pikëpyetje pohimet e saj të mëtejshme për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe informim. Theksoi se organi i paditur drejt e ka konstatuar gjendjen faktike, për çka propozon që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të konfirmohet aktvendimi për shqiptimin e përgjegjësisë kundërvajtëse.

Përgjigja në padi iu dorëzua të autorizuarit të paditësit për t'u njoftuar, pas së cilës i njëjti u deklarua me parashtresë me të cilën e njoftoi gjykatën se autorizimi i dhënë për përfaqësimin e paditësit Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë është revokuar, konform shkresës së dorëzuar nga ana e Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë më datë 23.09.2025, të cilën shkresë e dorëzojnë në shtojcë me parashtresën.

Paditësi, me parashtresë të dorëzuar në gjykatë në lëndën UPRK nr. 12/25, dorëzoi autorizim për përfaqësim, me të cilin për përfaqësues është autorizuar avokati Rozita Xhartovska nga Shkupi.

Gjykata Administrative, duke vepruar sipas padisë së paditësit pasi që konstatoi se padia është deklaruar në afatin ligjor të përcaktuar, se është e lejuar dhe e deklaruar nga personi i autorizuar dhe pasi vlerësoi se janë përmbushur kushtet ligjore, caktoi dhe mbajti seancë publike sipas padisë më datë 13.11.2025, në prani të të autorizuarit të paditësit avokat Rozita Xhartovska nga Shkupi, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të organit të paditur Valentina Nikollova dhe

Nadica Çetoroshka, në bazë të autorizimit të lëshuar nga Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03-289/1 dhe nr. 03-289/3.

Në seancën publike të mbajtur, i autorizuari i paditësit deklaroi se në tërësi mbetet pranë pretendimeve të theksuara në padi dhe kërkesëpadisë. Theksoi se organi i paditur me sjelljen e aktvendimit të kontestuar ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me ç'rast aktvendimi është i paqartë, i pakuptueshëm dhe nuk mund të shqyrtohet. Theksoi se gjendja faktike në procedurën që i ka paraprirë sjelljes së aktvendimit është konstatuar në mënyrë jo të plotë dhe jo të drejtë, si dhe se organi i paditur nuk ka vërtetuar se deklaratat e dy përfaqësuesve të Lidhjes së Odave Ekonomike kanë qenë të pasakta dhe jo të plota, as se të njëjtat kanë pasur aftësinë ta vënë organin në lajthitje. Theksoi se mbetet pranë provave të bashkangjitura në padi, se me prova të tjera nuk disponon dhe nuk propozon, andaj pas administrimit dhe vlerësimit të të gjitha provave propozoi që gjykata ta aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi, ta anulojë Aktvendimin P.P. nr. 09-32/12 të datës 23.05.2025 të organit të paditur dhe lëndën ta kthejë në rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i organit të paditur, Valentina Nikollova, deklaroi se në tërësi mbetet pranë pretendimeve të theksuara në përgjigjen e padisë. Theksoi se aktvendimi i kontestuar është sjellë në bazë të gjendjes faktike të konstatuar drejt dhe plotësisht, konform ligjit, dhe se në procedurë janë siguruar të gjitha provat relevante. Sipas organit të paditur, Lidhja e Odave Ekonomike ka dhënë të dhëna të pasakta dhe jo të plota, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi 1 pika 10 nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës. Theksoi se pohimet e paditësit se të dhënat nuk kanë qenë të pasakta janë të pabazuara, sepse paditësi gjatë procedurës nuk i ka mohuar deklaratat e pasakta të dhëna nga përfaqësuesit e tij, por i ka arsyetuar me keqkuptim dhe stres, gjë që nuk e përjashton përgjegjësinë. Theksoi se pasaktësia e të dhënave të dhëna nga paditësi në procesverbalet e datës 07.02. dhe 11.02. është e dukshme në mënyrë të pakontestueshme gjatë krahasimit me deklaratat e dhëna në procesverbal nga KAM SHPK më 10.02. dhe TINEKS MT SHPKNJ më 13.02. Theksoi se deklaratat e dhëna nga paditësi kanë mundur të ndikojnë thelbësisht mbi konstatimin e ekzistimit të marrëveshjes së ndaluar, që paraqet shkeljen më të rëndë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjë që e arsyeton kualifikimin juridik për kundërvajtje të kryer sipas nenit 61 paragrafi 1 pika 10. Propozoi që gjykata ta refuzojë padinë si të pabazuar dhe ta konfirmojë aktvendimin e Komisionit.

Në pyetjen e Kryetarit të Këshillit, pse organi i paditur konsideron se deklaratat e dhëna, gjegjësisht të dhënat e pasakta, e kanë vënë organin në lajthitje gjatë konstatimit të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se të njëjtat janë dhënë nga katër persona fizikë përfaqësues të autorizuar të personave juridikë, përfaqësuesi i autorizuar i organit të paditur deklaroi se nga deklaratat e Suzana Janevskës Komisioni nuk ka mundur të konstatojë se cilat markete kanë qenë pjesëmarrëse në takim, e me këtë edhe cilat markete do të ishin pjesëmarrës potencialë në marrëveshje eventualisht të ndaluar, që të mundet kundër të njëjtëve të ndërmarrë veprime hetimore dhe të inicojë procedurë kundërvajtëse.

Në pyetjen e Kryetarit të Këshillit, a kanë konstatuar edhe krahas deklaratave dhe gjithë dokumentacionit nga shkresat e lëndës se cilët kanë qenë pjesëmarrës të takimit, përfaqësuesi i autorizuar u përgjigj se, nga deklarata e personit të autorizuar Sasho Dukovski kanë konstatuar se cilët kanë qenë të pranishëm në takim. Përfaqësuesi i autorizuar i organit të paditur u përgjigj se, nga deklarata e Sasho Dukovskit kanë konstatuar se cilat markete ishin të pranishme në takim, por jo edhe cilët të gjithë nga Oda Ekonomike kanë marrë pjesë në atë takim. Gjegjësisht, Sasho Dukovski ka deklaruar se ai ka marrë pjesë në takim, në takim ka marrë

pjesë drejtori ekzekutiv Suzana Janevska dhe Kryetari i Lidhjes së Odave Ekonomike Trajan Angjellovski.

Në fjalët përfundimtare i autorizuari i paditësit deklaroi se nga pretendimet e theksuara në padi dhe përgjigjen e padisë, dhe nga të gjitha provat e administruara gjatë procedurës, u dëshmuua baza juridike e kërkesëpadisë dhe u dëshmuua se organi i paditur gabimisht e ka zbatuar nenin 61 paragrafi 1 pika 10 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës gjatë sjelljes së aktvendimit të kontestuar, prandaj propozoj që gjykata të sjellë aktgjykim me të cilin do ta aprovojë padinë në tërësi, do ta anulojë aktvendimin e kontestuar, ndërsa të paditurin do ta ngarkojë me shpenzime në shumë të përgjithshme prej 30.576,00 denarë, nga të cilat 9.100,00 denarë për përpilimin e padisë dhe nga 10.738,00 denarë për dy përfaqësime, si dhe taksë gjyqësore për padi dhe vendim sipas padisë prej 1.280,00 denarë.

Në fjalët përfundimtare përfaqësuesi i organit të paditur deklaroi se gjatë procedurës KVK saktë e ka konstatuar gjendjen faktike dhe ka sjellë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm, ndërsa në deklarinë gjatë procedurës paditësi nuk e konteston faktin se përfaqësuesit e tij kanë dhënë informacione të pasakta dhe jo të plota gjatë kontrollit, që është thelbi i kundërvajtjes së kryer. Propozojmë që gjykata ta refuzojë padinë si të pabazuar dhe ta konfirmojë aktvendimin e Komisionit.

Në procedurën e provave, Gjykata në seancën publike me lexim i administroi provat vijuese: Aktvendimi i kontestuar P.P numër 09-32/13 i datës 23.05.2025, Përgjigjja në padi PK nr. 09-32/16 e datës 19.06.2025, Dorëzimi i aktvendimit nr. 09-32/14 i datës 23.05.2025, Dëftesa për dorëzimin e aktvendimit, Deklarimi me shkrim lidhur me gjendjen faktike të konstatuar i datës 12.05.2025, Pasqyra e të dhënave nga llogaria vjetore për vitin 2024 nr. 09-602/2 e datës 03.04.2025 nga Regjistri Qendror, Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024, Deklarimi me shkrim lidhur me njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar i datës 27.03.2025, Autorizimi për përfaqësim nga avokati Rozita Xhartovska i datës 05.03.2025, Dorëzimi i Konkluzionit për iniciimin e procedurës kundërvajtëse nr. 09-32/9 i datës 21.02.2025, Përgjigjja nga Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë lidhur me Konkluzionin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse e datës 04.03.2025, Konkluzioni për iniciimin e procedurës kundërvajtëse nr. 09-32/1 i datës 21.02.2025, Kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse nr. 07-29/25 e datës 03.11.2022, Dorëzimi i konkluzionit nr. 07-29/3 i datës 07.03.2022, Konkluzioni nr. 07-29/2 i datës 03.03.2022, Përgjigjja sipas konkluzionit lidhur me 08-29/2 e regjistruar nën nr. 07-29/20 e datës 15.04.2022, Gjendja rrjedhëse nr. 0805-50/150020220283155 e datës 02.11.2022, Vërtetimi për dokumentacionin e marrë të Shoqërisë për tregti me shumicë dhe pakicë dhe shërbime TINEKS MT SHPKNJP eksport import Shkup, Procesverbali për kontrollin e kryer në TINEKS MT SHPKNJP eksport import, Shkup i datës 13.02.2025, Konkluzioni PK.nr. 09-15/10 i datës 11.02.2025, Vërtetimi për dokumentacionin e marrë nga Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë nr. 09-15/9 i datës 11.02.2025, Procesverbali i kontrollit në Lidhjen e Odave Ekonomike të Maqedonisë nr. 09-15/8 i datës 11.02.2025, Konkluzioni PK.nr. 09-15/7 i datës 11.02.2025, Vërtetimi për dokumentacionin e marrë nr. 09-15/6 i datës 10.02.2025, Procesverbali në KAM SHPK Ilinden nr. 09-15/5 i datës 10.02.2025, Konkluzioni PK.nr. 09-15/4 i datës 10.02.2025, Vërtetimi për marrjen e dokumentacionit PK.nr. 09-19/3 i datës 07.02.2025, Komunikatat për opinion, Procesverbali PK.nr. 09-15/2 i datës 07.02.2025, Konkluzioni PK.nr. 09-15/1 i datës 07.02.2025, Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror nr. 0805-50/150020250043618 e datës 07.02.2025.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësit, në bazë të pretendimeve dhe provave nga padia, përgjigjes në padi të organit të paditur, shkresave të lëndës të dorëzuara nga organi i paditur,

duke i pasur parasysh pretendimet në seancën publike të mbajtur dhe provat e administruara në të, gjeti se:

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e dorëzuara të lëndës rezulton se Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KVK), në bazë të nenit 41 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka sjellë Konkluzion nr. 09-15/1 të datës 07.02.2025, me të cilin i ka urdhëruar Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: LOEM) që të mundësojë kryerjen e papenguar të veprimeve nga neni 41 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nga ana e personave të autorizuar të Komisionit. Në bazë të konkluzionit të theksuar, më 07.02.2025, persona të autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës kanë kryer kontroll dhe mbledhje të provave në vendngjarje në hapësirat e LOEM. Për veprimet e kryera është përpiluar Procesverbali nr. 09-15/2, i nënshkruar në rregull nga personat e autorizuar dhe nga drejtori ekzekutiv i LOEM, Suzana Janevska.

Në mënyrë plotësuese, me Konkluzion nr. 09-15/7 të datës 11.02.2025, në bazë të nenit 41 të Ligjit, KVK urdhëroi mbledhje të sërishme të provave në vendngjarje nga ana e personave të autorizuar. Këto veprime u realizuan më 11.02.2025, ndërsa për të njëjtat u përpilua Procesverbali nr. 09-15/8, i nënshkruar në rregull nga personat e autorizuar, nga drejtori ekzekutiv i LOEM, Suzana Janevska, dhe nga nënkryetari i LOEM, Sasho Dukovski, i cili është edhe kryetar i Odës Tregtare pranë LOEM. Qëllimi i kontrollit të theksuar, konform konkluzioneve, ishte të konstatohet nëse veprimi i LOEM është në pajtim me nenin 7 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke pasur parasysh informacionet e marra nga mediat dhe burime të tjera se më 05.02.2025 në hapësirat e LOEM është mbajtur takim me përfaqësues të zinxhirëve të shitjes me pakicë, në të cilin është dakorduar që të mos pranohen çmimorë të rinj deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2025. Një marrëveshje e tillë, nëse ekziston, paraqet marrëveshje kufizuese të ndaluar me nenin 7 të Ligjit. Në procesverbalin e datës 07.02.2025, persona të autorizuar nga KVK i kanë pyetur Suzana Janevskën dhe Sasho Dukovskin për përmbajtjen e takimit, organizimin e tij, praninë dhe dokumentacionin lidhur me të njëjtin. Suzana Janevska ka deklaruar se nuk ka qenë e pranishme në takim, se i njëjti është organizuar nga Sasho Dukovski, i cili ka qenë i pa pranishëm në momentin e kontrollit, se e ka kontaktuar përmes telefonit dhe ka marrë udhëzim të mundësojë informacione shtesë më 10.02.2025, dhe se nuk e di nëse ndonjë nga të punësuarit në LOEM ka siguruar mbështetje administrative për takimin. Në procesverbalin e datës 11.02.2025, në pyetjen për organizimin e takimit, qëllimin e tij dhe të pranishmit, Sasho Dukovski ka deklaruar se bëhet fjalë për takim joformal me të njohur personalë, të mbajtur më 05.02.2025, në të cilin ai personalisht ka qenë përfaqësuesi i vetëm nga LOEM, ndërsa në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues nga Tineks, KAM, Vero dhe Reptil. Dukovski theksoi se takimi është organizuar personalisht nga ai. Megjithatë, nga deklaratat e pjesëmarrësve të tjerë të takimit, të dhëna në procesverbalet nr. 09-15/5 të datës 10.02.2025 dhe nr. 09-15/11 të datës 13.02.2025, rezulton se në takim kanë marrë pjesë më shumë persona nga LOEM, ndër të cilët Trajan Angjellovski kryetar i LOEM, Suzana Janevska drejtor ekzekutiv, dhe Sasho Dukovski nënkryetar i LOEM, si dhe përfaqësues të zinxhirëve të shitjes me pakicë. Gjithashtu, nga deklaratat e dhëna rezulton se takimi është caktuar nga ana e Sasho Dukovskit dhe se ka pasur mbështetje administrative për organizimin e tij.

Gjatë kontrollit në postën elektronike të LOEM (koordinator@sojuzkomori.org.mk), persona zyrtarë nga KVK konstatuan se ekzistojnë më shumë porosi elektronike lidhur me takimin, të shkëmbyera më 05.02.2025 dhe 06.02.2025, të cilat përmbanin informacione për caktimin, praninë dhe përmbajtjen e takimit. Konkretisht, janë gjetur porosi elektronike nga pjesëmarrës

të takimit, duke përfshirë edhe porosi të dërguara te Sasho Dukovski dhe Trajan Angjellovski, si dhe porosi të cilat tregojnë se ka ekzistuar komunikim pas përfundimit të takimit. Sipas kësaj konstatuar se deklaratat e Suzana Janevskës dhe Sasho Dukovskit, të dhëna në procesverbalet nr. 09-15/2 dhe nr. 09-15/8, se nuk kanë pasur informacione ose nuk kanë pasur pjesëmarrje, janë të pasakta dhe jo të plota. Për shkak të kësaj, KVK me Konkluzion nr. 09-32/1 të datës 21.02.2025 inicoi procedurë kundërvajtëse kundër Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë, për shkak të dhënies së të dhënave të pasakta, jo të plota dhe të dhënave të cilat mund ta vënë Komisionin në lajthitje gjatë kryerjes së kontrollit konform nenit 41 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi 1 pika 10 nga Ligji. Gjatë zbatimit të procedurës, LOEM është deklaruar sipas konkluzionit për iniciimin e procedurës kundërvajtëse me shkresë nr. 09-32/3 të datës 04.03.2025, si dhe sipas njoftimit preliminar (nr. 09-32/7 të datës 27.03.2025) dhe njoftimit përfundimtar (nr. 09-32/12 të datës 12.05.2025). Në parashtresat e saj, LOEM ka theksuar se pasaktësitë eventuale në deklaratat kanë qenë rezultat i keqkuptimit në komunikim, se nuk ka pasur qëllim të pengohet procedura, dhe se përfaqësuesit e saj kanë bashkëpunuar plotësisht me personat zyrtarë të Komisionit gjatë kontrollit dhe mbledhjes së provave. Në bazë të gjendjes faktike të konstatuar kështu, organi i paditur e ka sjellë aktvendimin e kontestuar PK nr. 09-32/13 të datës 23.05.2025 me të cilin ka konstatuar se tani paditësi ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi 1 nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, për të cilën i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 60.000,00 denarë, të cilën është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, Gjykata gjeti se procedura e cila i ka paraprirë aktit administrativ të kontestuar është zbatuar konform ligjit dhe se vendimi është i drejtë dhe i ligjshëm.

Në përputhje të nenit 3 paragrafi 1 pika 3 nga Ligji për Kontestet Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19), është paraparë se për shkak të sigurimit të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridikë të personave fizikë dhe juridikë dhe për shkak të sigurimit të ligjshmërisë, Gjykata Administrative në kontestet administrative vendos për ligjshmërinë mes tjerash edhe të akteve të sjella në procedurë kundërvajtëse.

Në përputhje të nenit 7 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 145/2010...83/18), ndalohen të gjitha marrëveshjet e lidhura me ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe sjellja e bashkërenduar qëllimi ose pasoja e të cilave është shtrembërimi i konkurrencës, e posaçërisht ato të cilat: në mënyrë direkte ose indirekte fiksojnë çmimet e blerjes ose të shitjes ose disa kushte të tjera për tregti; e kufizojnë ose e kontrollojnë prodhimin, tregun, zhvillimin teknik ose investimet; e ndajnë tregun ose burimet e furnizimit; zbatojnë kushte të ndryshme për punë juridike të njëjta ose të ngjashme me partnerë të tjerë tregtarë, me çka i vënë në pozitë konkurruese më të pavorshme ose e kushtëzojnë lidhjen e marrëveshjeve me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të obligimeve plotësuese, që për nga natyra e tyre ose në pajtim me zakonet tregtare nuk janë në lidhje me lëndën e marrëveshjes.

Në përputhje të nenit 30 paragrafi 1 nga ligji i njëjtë, për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj, procedurë kundërvajtëse para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës udhëheq dhe sanksion kundërvajtës shqipton Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje.

Në përputhje të nenit 32 paragrafi 1 nga ligji i njëjtë, procedurë kundërvajtëse para Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje inicohet sipas detyrës zyrtare, me kërkesë të sekretarit të

përgjithshëm të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës ose me kërkesë të personit fizik ose juridik i cili ka interes legjitim për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes.

Në përputhje të nenit 61 paragrafi (1) pika 10 nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje ndërmarrjes, gjegjësisht shoqatës së ndërmarrjeve, me aktvendim mund t'i shqiptojë gjobë në shumë deri në 1% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore, të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në vlerë absolute dhe nominale, për të cilën ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka llogari vjetore të përpiluar, nëse: personi i autorizuar ose i punësuar tjetër jep të dhëna të pasakta, jo të plota ose të dhëna të cilat mund ta vënë në lajthitje Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Komisionin për Vendimmarrje për Kundërvajtje, në kuptim të neneve 41 paragrafi (1) pikat 7 dhe 8 dhe 50 paragrafi (1) pikat 7 dhe 8 nga ligji i njëjtë.

Në përputhje të nenit 41 paragrafi 1 nga Ligji i njëjtë, nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se ndërmarrja e caktuar posedon dokumente ose sende të tjera ose ka njohuri të cilat mund të jenë me rëndësi që të dëshmohet ekzistimi i kundërvajtjes, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje mundet me konkluzion t'i urdhërojë asaj ndërmarrjeje, personave të autorizuar nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe personave të cilët sipas nevojës i shoqërojnë: t'u mundësojë pa pengesë të hyjnë në cilat do hapësira afariste, tokë ose mjete transporti të ndërmarrjes të cilat janë me rëndësi për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes; t'u mundësojë pa pengesë t'i kontrollojnë librat ose dokumentacionin tjetër të cilat janë me rëndësi për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes, pa marrë parasysh mediumin në të cilin ruhet e njëjta; t'u mundësojë pa pengesë të marrin ose të mbajnë në cilëndo formë kopje ose ekstrakte nga ato libra ose dokumentacion; t'u mundësojë pa pengesë përkohësisht t'i marrin dhe t'i mbajnë librat ose dokumentacionin tjetër të cilat janë me rëndësi për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes për periudhën e nevojshme për kopjimin e të njëjtave, nëse kopjimi i tyre nuk mund të kryhet në vendin e ngjarjes. Për marrjen dhe mbajtjen e tillë, personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës lëshojnë vërtetim me shkrim në të cilin përshkruhen librat e marra dhe dokumentacioni tjetër dhe shënohet se ku janë gjetur; t'u mundësojë përkohësisht të marrin dhe të mbajnë sende, libra ose dokumentacion tjetër të cilat janë me rëndësi për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes për periudhën e nevojshme për konstatimin e fakteve dhe provave relevante që rezultojnë nga ato sende, libra dhe dokumentacion, por jo më gjatë se përfundimi i plotfuqishëm i procedurës lëndore. Për marrjen dhe mbajtjen e tillë, personat e autorizuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës lëshojnë vërtetim me shkrim në të cilin përshkruhen sendet, librat e marra dhe dokumentacioni tjetër dhe shënohet se ku janë gjetur; t'u mundësojë pa pengesë t'i vulosin hapësirat afariste dhe librat ose dokumentacionin tjetër për periudhën dhe në vëllimin e nevojshëm për kontrollin, por jo më gjatë se shtatë ditë; personi i autorizuar ose i punësuar tjetër në ndërmarrje të japë në procesverbal sqarim për faktet ose dokumentet të cilat janë me rëndësi për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes; personi i autorizuar ose i punësuar tjetër në ndërmarrje të dorëzojë sqarim me shkrim për faktet ose dokumentet të cilat janë me rëndësi për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes në afat të caktuar dhe t'u mundësojë kryerjen e papenguar të veprimeve të tjera të cilat janë me rëndësi për konstatimin e ekzistimit të kundërvajtjes.

Në përputhje të nenit 48 paragrafi 1 nga Ligji i njëjtë, nëse ekzistojnë rrethana të cilat tregojnë mundësinë që konkurrenca të jetë e shtrembëruar, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës mund të zbatojë hulumtim në sektor të caktuar të ekonomisë ose për lloj të caktuar të marrëveshjeve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Gjatë hulumtimit, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës mundet me konkluzion të kërkojë nga ndërmarrjet të dorëzojnë të dhëna lidhur me gjendjen e tyre ekonomike-financiare, marrëdhëniet dhe lidhjet e tyre afariste,

të dhëna për statutet dhe vendimet e tyre, për numrin dhe identitetin e personave të prekur me vendimet e tilla, si dhe të dhëna të tjera me rëndësi për hulumtimin. Konkluzioni nga paragrafi (2) i këtij neni përmban bazën juridike, qëllimin e kërkesës, shënimin e saktë të të dhënave që kërkojnë dhe afatin për dorëzimin e të dhënave të kërkuara, si dhe atë se mosdorëzimi i informacioneve në afatin e kërkuar ose dorëzimi i të dhënave të pasakta, jo të plota ose të dhënave të cilat mund ta vënë në lajthitje Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës paraqet kundërvajtje, konform nenit 61 të këtij ligji. Kundër konkluzionit nuk lejohet ankesë, as padi për iniciimin e kontestit administrativ. Sekretari i përgjithshëm i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës mundet në bazë të të dhënave të siguruara me hulumtimet të parashtrijë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje. Nëse disa nga të dhënat paraqesin fshehtësi afariste, ndërmarrjet janë të obliguara që të njëjtat qartë t'i shënojnë dhe ta shënojnë bazën juridike. Gjatë dorëzimit të të dhënave të cilat paraqesin fshehtësi afariste, ndërmarrjet janë të obliguara që te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojnë një kopje me të dhëna të përfshira (version i besueshëm) dhe një kopje në të cilën do të jenë të fshira të dhënat (version jo i besueshëm).

Në përputhje të nenit 64 paragrafi 1 nga ligji i njëjtë, gjatë matjes së gjobës merren parasysh: 1) pesha e kundërvajtjes; 2) kohëzgjatja e kundërvajtjes dhe 3) shkalla e shtrembërimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara me kundërvajtjen. Konform paragrafit 2, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje, gjatë matjes së gjobës, së pari përcakton shumën bazë të gjobës, e pastaj të njëjtën e përshtat, duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese ose rënduese. Konform paragrafit 3, Shuma bazë e gjobës sipas rregullit arrin më së shumti deri në 30% nga të ardhurat e kryesit të kundërvajtjes të realizuara nga veprimtaria e cila kryhet në tregun relevant në të cilin është kryer kundërvajtja në vitin e fundit të plotë afarist në të cilin kryesi i kundërvajtjes ka marrë pjesë në të njëjtin. Shuma e përcaktuar kështu shumëzohet me numrin e viteve në të cilat ka zgjatur kundërvajtja. Konform paragrafit 4, Shuma e përcaktuar në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni përshtatet duke marrë parasysh rrethana lehtësuese ose rënduese, si rezultat i së cilës e njëjta mund të jetë e zvogëluar ose e zmadhuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, e dukshme nga të gjitha provat e administruara në procedurë, si dhe nga materiali i plotë provues, procesverbalet zyrtare, deklaratat e personave të autorizuar, korrespondenca dhe të dhënat e dorëzuara, rezulton se organi ka vepruar konform nenit 28 paragrafi 2 dhe nenit 30 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me ç'rast janë siguruar, analizuar dhe vlerësuar drejt procesverbalet e datës 07.02.2025 dhe 11.02.2025, komunikimi elektronik i Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë Bashkësia e Interesit Ekonomik Shkup, si dhe deklaratat e të gjithë pjesëmarrësve në procedurë. Drejt është konstatuar se paditësi LOEM përmes personave të tij përgjegjës, ka dhënë informacione të pasakta, jo të plota dhe reciprokisht kundërthënëse lidhur me mbajtjen e takimeve të koordinuara me përfaqësues të zinxhirëve tregtarë. Sjellja e këtillë, e vlerësuar në kontekst të rrethanave të konstatuara dhe pranisë dhe veprimit të ndërsjellë të personave të autorizuar, tregon për ekzistimin e veprimit të koordinuar dhe të dakorduar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për shkak të së cilës organi me bazë ka konstatuar kundërvajtje. Gjykata vlerësoi se arsyet e theksuara në aktvendimin e kontestuar janë arsyetuar qartë, të mbështetura me argumente dhe të harmonizuara reciprokisht, me ç'rast bazohen në prova konkrete dhe relevante. Pretendimet faktike dhe juridike të konstatuara nuk tregojnë për ekzistimin e shkeljeve thelbësore të procedurës, as për zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kënde, Gjykata konkludon se aktvendimi i kontestuar është sjellë në pajtim me dispozitat e zbatueshme të së drejtës materiale dhe procedurale, ndërsa vlerësimi i provave është i drejtë, i plotë dhe adekuat me gjendjen faktike të konstatuar.

Duke pasur parasysh gjithë këtë që u theksua më lart, Gjykata konstatoi se padia e paditësit është e pabazuar dhe vendosi si në dispozitivin e aktgjykimit, në përputhje të nenit 59 paragrafi 1 të Ligjit për Kontestet Administrative ("Gaz. Zyrtare e RMV" nr. 96/19).

Kërkesën e paditësit për kompensimin e shpenzimeve në procedurë, gjykata e refuzoi si të pabazuar, në përputhje të dispozitës nga neni 86 paragrafi 3 nga Ligji për Kontestet Administrative ("Gaz. Zyrtare e RMV" nr. 96/19), me të cilën është paraparë nëse gjykata e refuzon padinë, secila palë t'i bartë shpenzimet e veta në procedurë.

Gjykuar në Gjykatën Administrative më datë 20.11.2025, nën UPRK.nr. 12/2025.

Procesmbajtës -këshilltar gjyqësor
mr. Ate Me Muamed

Gjyqtar,
mr. Burim Sejdi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesë në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate deri te Gjykata e Lartë Administrative.

Urdhër për taksë: Obligohet paditësi të paguajë taksë gjyqësore për vendim në shumë prej 800.00 denarë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i vendimit dhe atë si pranues Buxheti i R. së Maqedonisë së Veriut, banka e pranuesit BPRMV, taksa gjyqësore nga persona fizikë llogaria numër 1000-000-000-630-95, Llogaria e pagesës: 840-182-03359 Shifra e të ardhurave: 72-22-13, Programi: 00, Mënyra: 2, gjegjësisht taksa gjyqësore nga persona juridikë banka e pranuesit BPRM llogaria numër 1000-000-000-630-95, Llogaria e pagesës: 840-182-03338, Shifra e të ardhurave: 72-22-11, Programi: 00, Mënyra: 2, në të kundërtën do të paguhet dhunshëm përmes Drejtorisë për të Ardhurat Publike e zmadhuar për 50%.

Aktgjykimi t'i dorëzohet:

-paditësit- të autorizuar;
-organit të paditur.

Gjyqtar,
mr. Burim Sejdi